

Përshëndetje,

Në përgjigje të kërkesës së Drejtorit Ekzekutiv të Qendrës “Res Publica”, Av. Dorian Matlija, me nr.Prot. 03/26, datës 4.2.2026, të adresuar pranë Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, nëpërmjet adresës info@ambu.gov.al në datën 4.2.2026, në lidhje me:

- Sa është sasia e ujit që devijohet nga burimi/lumi përmes kanali vaditës Zhulat – Taroninë (në m³/s dhe m³/vit)?
- A ekzistojnë të dhëna teknike, projekte ose matje zyrtare mbi sasinë e ujit të devijuar?
- A është pajisur ky kanal vaditës me leje për përdorimin e burimeve ujore, sipas legjislacionit në fuqi?
- Nëse po, ju lutem të na vini në dispozicion kopje të lejes/leve përkatëse;
- Në cilën periudhë të vitit operon ky kanal vaditës?

Ju informojmë, nga verifikimet e kryera në regjistrin kombëtar të lejeve/autorizimeve të dhëna nga organet e menaxhimit të burimeve ujore, rezulton se nuk kemi leje aktive përdorimi burimi ujqor, të lëshuara nga Këshilli i Basenit Lumor, dhe gjithashtu nuk kemi aplikim në sistem të këtij burimi ujqor në rastin konkret për kanalin vaditës Zhulat-Taroninë.

Thënë sa më lart, për tu përgjigjur pyetjeve tuaja, nuk kemi informacion pasi ky kanal vaditës nuk figuron me leje nga organet e menaxhimit të burimeve ujore pra nuk disponojmë dokumentacion teknik (për sasinë e ujit që merr, projekte teknike si dhe për periudhën që operon).

Informacionin e kërkuar mund ta siguroni nga Ministria e Bujqësisë si organ që administron këto vepra.

Punë të mbarë.